



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

OSNOVNI SUD PRIŠTINA - OGRANAK GRACANICA

Broj predmeta: 2024:238057

Datuma: 09.10.2024

Broj dokumenta: 06274995

K.nr.320/24

NE EMER TE POPULIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-Dega Graçanice - Departamenti i Pergjithshem, Divizioni Per Kundervajtje, në përbërje të gjyqtarit të vetem Siniša Borisavljević, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Dijana Antić, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures **D, Bahtiri** nga Dobraje e Madhe, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 231, par.1 të LRRTRR, (Ligji nr. 05/L-088) dhe neni 3, dhe 19 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e LRRTRR (Ligji nr.06/L-069), në bazë të neneve 55,77,86,119,124 dhe 127 të Ligjit për Kundërvajtje (nr. 05/L-087), më datë 09.10.2024 merr këtë:

AKTGJYKIM

E pandehura **D, B**, e lindur më dt. , në Prishtinë me vendbanim në rr. “,” nr 20, fsh Dobraje e Madhe K. Lipjan, e pa punë, e pamartuar, e gjendjes së dobët ekonomike, me numer personal ,, , Shqiptare, shtetas i R. Kosovës

Është përgjegjës

Sepse më datë ,, , të ora 17:50 në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj ne Qaglavice te rrethi, Komuna Graçanice, gjer sa ishte duke drejtuar automjetin markës “Mercedes“, me targa të regjistrimit ,, , është ndaluar nga Njësi i Trafikut Rrugor, me ç’rast pas kërkimit të dokumentacionit të automjetit, është konstatuar se i njëjti ka drejtuar automjetin e lartpërmendur pa patent shofer përkatësisht pa e fituar të drejtën për drejtimin e automjetit

- me çka ka kryer veprën kundërvajtëse nga neni 231 par. 5 të LRRTRR-së (Ligji nr. 05/L-088) dhe neni 19 të Ligjit për Plotësim dhe Ndryshim të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor (Ligji nr.06/L-069)

- andaj në bazë të dispozitave të theksuara ligjore, si dhe neni 35 par.1 të Ligjit për Kundërvajtje:

D Ë N O H E T

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej 150 € (njëqind e pesëdhjetë euro)

Oblihohet e pandehura që ta paguaj gjoben në vlerë prej **150 euro**, në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse nuk e paguan në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbarim.

E pandehura, obligohet që në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **10 € (dhjetë euro)** në afatin e njëjtë sikurse denimin në të holla në kuptim të nenit 59, dhe 76, të LK-së.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi ti dërgohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m i

Stacioni Policor-NJRKRR në Fushe Kosove, kësaj Gjykate i ka parashtruar Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse **nr.,, dt. 09.07.2024** kundër të pandehures të lartëshenuar, për shkak të veprës kundërvajtëse nga neni 231. par.1 të LRRTRR, me të cilën ka kërkuar që pranë kësaj gjykate të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe pas administrimit të provave të propozuara, i njëjti të shpallet përgjegjës dhe të denohet sipas dispozitave ligjore.

Gjyqtari, filloi procedurën kundërvajtëse, në seance date ,,,,,,,,,,,,,,, duke e marr në pyetje të pandehures, e cila në deklaratën-mbrojtjen e tij, në tërësi pranoi veprën kundërvajtëse e cila i ngarkohet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj për këtë nuk pati nevojë që të administrohen prova tjera. Njëherit i ka premtuar gjykatës se nuk do të marrë pjesë më në komunikacion për deri sa nuk kualifikohet për drejtimin e automjetit.

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, deklaratës së të pandehures si dhe kërkesën e stacionit policor, gjyqtari i çështjes erdhi në përfundim se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha elementet e veprës kundërvajtëse të parapara sipas dispozitave të nenit 231, par.1 lidhur me par. 1, të LRRTRR, dhe nenit 19, të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, ashtu që të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjyqtari duke marr parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 31, dhe 35. të Ligjit për Kundërvajtje e sidomos peshën e veprës kundërvajtëse dhe pasojat, rrethanat nën të cilat është kryer kundërvajtja, gjendjen e tij personale si dhe atë pasurore, shkallën e përgjegjësisë dhe tiparet personale të tij, pranimin e fajsisë, është përdur dhe ka premtuar se nuk do t'a përsëris mënjë veprim të tillë, andaj bazuar në të gjitha këto rrethana, të pandehurit iu shqiptua një dënim i tillë me bindje se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor.

Për shkak të gjitha të lartcekurave, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINE-DEGA GRAQANICE
Departamenti i pergjithshem, Divizioni per kundervajtje
K.nr 320/24 nga 09.10.2024.

Gjyqtari
Siniša Borisavljević

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtroj ankesë paraqitësi i kërkesës dhe i pandehuri, në afat prej **8 ditësh** nga dita e pranimit të aktgjykimit në Gjykatën e Apelit-Departamenti për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.

Përktimi: Hekuran Mavriqi